



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 196, Datë 26.11.2020

“MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË
PAJTUESHMËRISË TË OSSH SH.A”.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 72, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, gërma “f”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 123/5 prot, datë 23.11.2020, të Drejtorive Teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së OSSH sh.a.,

Konstatohet se:

- Shoqëria OSSH sh.a. me shkresën nr. 8669 prot, datë 12.11.2020 i është drejtuar Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me kërkesën për miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a).
- Siç edhe përcaktohet në nenin 72, pika 3, gërma “b” të Ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë”, i ndryshuar, OSSH sh.a ngarkohet “*të hartojë një program pajtueshmërie që përcakton masat që do të merren për të siguruar ndalimin e veprimeve diskriminuese, si dhe të sigurojë që respektimi i programit të monitorohet në mënyrën e duhur*”.

Pikat e Programit të Pajtueshmërisë për të cilat ERE evidenton nevojën e diskutimit me OSSH sh.a dhe palët e interesit janë:

- **Pika 2** e Programit të Pajtueshmërisë parashikon caktimin e Zyrtarit të pajtueshmërisë me Vendimin e ERE, përgjegjësitë e tij në lidhje me sigurimin e pajtueshmërisë, paraqitjen e Raportit të pajtueshmërisë pranë ERE, monitorimin lidhur me respektimin e detyrimeve ligjore të Programit të Pajtueshmërisë, si dhe ndryshimet apo rishikimet e nevojshme të këtij Programi me miratimin e ERE-s, siç është parashikuar në nenin 72, pika 3, gërma “b”, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar. Në nenin 72, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” parashikohet edhe përcaktimi në vijim: “*Për të përmbushur detyrat e tij, Zyrtari i pajtueshmërisë duhet të jetë plotësisht i pavarur dhe ka*

akses në të gjitha informacionet e nevojshme të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe çdo shoqërie të lidhur, për të përmbushur detyrën e tij”.

- Vihet re se në Programin e Pajtueshmërisë mungon informacioni nga ana e OSSH sh.a. mbi kushtet për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të pajtueshmërisë, si dhe garancitë që pavarësia e tij në ushtrimin e kompetencave me të cilat e ka ngarkuar ligji por edhe vetë Programi i Pajtueshmërisë, nuk do të çënohen gjatë ushtrimit të aktivitetit.
- **Pika 3**, përcakton të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të OSSH sh.a në kuadër të Programit të Pajtueshmërisë si: njohja me të, deklarimi i gatishmërisë për zbatimin e tij dhe mbështetja në mënyrë aktive e Zyrtarit të pajtueshmërisë. OSSH sh.a ofron gjithashtu trajnime për punonjësit sa i përket zbatimit të tij.
 - **ERE vlerëson se, nënshkrimi i Programit të Pajtueshmërisë**, do të përbënte një garanci më shumë për njohjen e tij.
- **Pika 4**, parashikon pavarësinë e organeve drejtuese të OSSH sh.a, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga neni 72, pika 3, e Ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar. Në këtë kre parashikohen kushtet të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e plota vendimmarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar për të siguruar funksionimin, mirëmbajtjen apo zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, hartimin dhe depozitimin në ERE të programit vjetor, detyrimet e personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes mes të cilave është dhe **nënshkrimi i deklaratës së pavarësisë**.
- Në nenin 26 të Direktivës 2009/72/EC parashikohet gjithashtu se: Punonjësit do të jenë subjekt vetëm i autoritetit menaxhues të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe promovimi e sanksionet mund të vendosen vetëm nga menaxhimi i tij.
- Programi i Pajtueshmërisë së OSSH sh.a. është miratuar me vendimin nr.18/ 2020 të Këshillit të Administrimit.
- Rezulton se Programi i Pajtueshmërisë propozuar nga OSSH sh.a. me shkresën nr. 8669 prot, datë 12.11.2020, ka reflektuar në përgjithësi kërkesat e Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe të Direktivës 2009/72/EC, sa i takon ndarjes dhe pavarësisë së OSSH sh.a. si dhe shmangies së diskriminimit.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së OSSH sh.a.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI